

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike ka për *mission* garantimin e aksesit të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë nëpërmjet ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Gjatë ushtrimit të *veprimtarisë* së saj, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas garanton përdorimin e mjeteve efektive për të siguruar përmbushjen e qëllimit të ligjit për ndihmën juridike, përmes:

- a) Sigurimit të zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e ndihmës juridike;
- b) Zbatimit të politikës shtetërore në fushën e ndihmës juridike;
- c) Ligjshmërisë së procedurave në ofrimin e ndihmës juridike falas, duke mbikëqyrur standardet e ofrimit të ndihmës juridike sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 5 të ligjit për ndihmën juridike;
- d) Bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike;
- e) Rritjes së ndërgjegjësimit tek qytetarët në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e të gjithë aktorëve të përfshirë.